



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

K R Y E T A R I

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë. Tel. 04.224 332

Nr. 429/9 Prot.

Tiranë, më 30/09/2017

V E N D I M

Nr. 135, Datë 30/09/2017

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR
NË BASHKINË PUKË DHE 4 ISH-KOMUNAT GJEGJAN, QERET, RRAPE DHE
QELËZ "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË
FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare" të ushtruar në Bashkinë Pukë, sipas programit të auditimit nr. 492/1 prot., datë 16.05.2017, për periudhën 01.01.2015 deri 31.12.2016 dhe 4 ish-Komunat; Gjegjan, Qerret, Rrapë dhe Qelëz, për periudhën nga data 01.01.2013 deri 31.07.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASAT ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nuk janë implementuar plotësisht kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" lidhur me:

-Mjedisin e kontrollit. Bashkia Pukë, ka të miratuar në strukturën e vet, 21 pozicione pune, pjesë të shërbimit civil. Nga këto, vetëm për 6 pozicione pune janë emëruar punonjës që trajtohen me statusin e nëpunësit civil kurse për 15 pozicione të tjera, janë emëruar punonjës pa procedurën e konkurrimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 "Për statusin e nëpunësit civil" të ndryshuar nenet 4, 19, 20, 22 dhe 24.

-Sistemi i kontrollit. Struktura organizative është e organizuar me 4 Njësi; Sektori i Zhvillimit të Sportit, Sektori i Zhvillimit të Kulturës, Sektori i Konviktit dhe i Çerdhes dhe Sektori i Pastrim Gjelbërimit. Detyrat funksionale për çdo zyrë dhe sektor, janë përcaktuar në rregulloren e funksionimit të brendshëm, miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 247, datë 30.12.2015. Në strukturën organizative është parashikuar Njësia e Auditimit të Brendshëm me 3 punonjës por në fakt nuk është krijuar kjo Njësi.

Në total struktura organizative është parashikuar me 93 punonjës, në fakt janë 80 punonjës nga të cilët 33 janë punonjës të Administratës.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masat, të procedojë sipas kërkesave ligjore për rekrutimin e punonjësve në pozicionet e punës që trajtohen sipas ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014.

2.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë të marrë masa për organizimin shërbimit të auditimit të brendshëm në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditin e brendshëm publik” neni 10 “Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik”, pika 1.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

2. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2015 dhe 2016, buxheti i Bashkisë Pukë, është miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë, respektivisht:

Për vitin 2015 miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 2, datë 6.02.2015 dhe për vitin 2016, është miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 10, datë 24.02.2016.

Për vitin 2015, janë programuar gjithsej 257,883 mijë lekë shpenzime, realizuar në fakt 225,201 mijë lekë ose 87%, investimet janë realizuar në masën 95%.

Realizimi i të ardhurave nga tatim taksat lokale, është në masën 56%.

Për vitin 2016, janë programuar gjithsej 534,149 mijë lekë shpenzime, realizuar në fakt 391,218 mijë lekë ose 73% e programimit, investimet janë realizuar në masën 51%.

Realizimi i të ardhurave nga tatim taksat lokale, është në masën 55%.

Mos realizimi i treguesve të buxhetit, ka sjellë mos balancimin e të ardhurave me shpenzimet dhe rritjen e detyrimeve ndaj të tretëve, nga 51,114 mijë lekë në vitin 2015, në **53,413 mijë** lekë në vitin 2016, nga të cilat 12.414 mijë lekë, janë detyrime sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Për periudhën e viteve 2015-2016, gjendja debitorë është pakësuar me 780 mijë lekë, kurse detyrimet kreditore, janë rritur për 2,299 mijë lekë duke përkeqësuar treguesit financiarë që tregon për programim dhe zbatim të buxhetit në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 34, pika 6 ku përcaktohet se: “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”.

2.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masat, që për vitin 2018, të programojë një buxhet sa më real dhe të balancuar sipas kërkesave ligjore. Të marrë masat, për të rritur treguesit e të ardhurave nga tatim taksat lokale, reduktimin e shpenzimeve dhe eliminimin e investimeve që kryejnë ndaj të tretëve.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi rregullshmërinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare, u konstatuan disa pasaktësi:

-Llogaria e aktivitetit të bilancit 202 “Shpenzime për studime ose kërkime”, për vlerën e debisë 10,015,337 lekë në analizë të saj ka të evidentuar vlerën e shpenzimeve për studime

projektimi dhe oponenta teknike të kryera në vite. Për këto aktive, nuk janë hapur kartela inventariale për personat që i kanë në ngarkim dhe i administrojnë këto studime dhe projekte. Vlera e këtyre studimeve dhe projekte, nuk janë kontabilizuar në debi të objekteve të investuara dhe të përfunduara.

-Llogari 212 “Ndërtim e konstruksione”, për vlerën e debisë 557,092,063 lekë, nuk është e sistemuar në të gjitha rastet në shtesë të vlerës për vlerën e objekteve të ri konstruktura, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Përsa më sipër, janë shkelje të kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, nenet 7, 9 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73 dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1.

3.1. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për të sistemuar kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me qëllim që ato të pasqyrojnë gjendjen reale të aktiveve të Bashkisë Pukë.

Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës dhe të Shërbimeve, bazuar në të dhënat kontabël, të marrin masat dhe të organizojnë evidencën e inventarit të studimeve dhe projekteve të investuara në vite në Bashkinë Pukë dhe në ish Komunat, sot Njësi Administrative. Administrimi i tyre të bëhet sipas procedurave ligjore, me kartela inventari, në ngarkim të personave që i kanë në administrim.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

4. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Pukë, nuk është miratuar krijimi i strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e kundërligjshme” të ndryshuar, neni 3, ligjit nr. 107/2014, datë 29.04.2009 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, nenet 13, 29 si dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, neni 10 pika 14 dhe neni 14.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se në Bashkinë Pukë dhe ish komunat; Qerret, Qelëz, Gjegjan dhe Rrape, nuk janë evidentuar raste të ndërtimeve pa leje.

4.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Pukë, të merren masa për organizimin e ushtrimit të funksionit për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e kundërligjshme duke krijuar strukturën përkatëse ose duke e deleguar këtë shërbim, në zbatim të kërkesave ligjore.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pukë dhe ish Komunat: Qerret, Gjegjan, Rrapë dhe Qelëz, (Sot Njësi Administrative të Bashkisë Pukë), kanë miratuar projektet e mbarështimit për pyjet dhe kullotat që me VKM, kanë kaluar në pronësi ose në përdorim të Njësite të Vetëqeverisjes Vendore.

Nga këto Njësi të Qeverisjes Vendore, nuk janë parashikuar fonde për kryerjen e investimeve të nevojshme në zbatim të projekteve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave sipas parashikimeve në planet e mbarështimit.

Nga Bashkia Pukë, nuk janë ngritur komisionet përkatëse për marrjen në dorëzim *në terren* të pyjeve dhe kullotave që janë miratuar në pronësi me VKM nr. 433, datë 8.06.2016, me qëllim për të përcaktuar *statusin juridik aktual të tyre* dhe për regjistrimi në pronësi pranë ZVRR,

në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar neni 7.8, ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, neni 5, ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1.2 dhe neni 27 pika 5 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, kap. III, pika 20, 21, 22, 30 dhe pika 35/a.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masat e nevojshme për evidentimin e saktë dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave në zbatim të kërkesave ligjore.

Të administrojë dhe vlerësojë dokumentacionin tekniko ligjor nga ish Komunat sot Njësi Administrative dhe me komisione të specializuara, të vlerësojë statusin juridik të pyjeve dhe kullotave që me VKM janë miratuar në pronësi të ish Komunave sot Njësi Administrative dhe të Bashkisë Pukë.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

6. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Gjegjan, në vitin 2013 janë miratuar dhënia e 5 lejeve ndërtimore pa pasur Plan Urbanistik të miratuara dha pa pasur vërtetim mbi pronësinë e truallit për ndërtimin e objektit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 për “Planifikimin e territorit”, për objekt:

-Leje ndërtimi nr. 935 prot., datë 7.11.2013 për objektin: “*Lokal shërbimi*”. Investitor: N. L. Sipërfaqja ndërtimore 58 m².

-Leje ndërtimi nr. 436, datë 23.04.2013 për objektin: “*Lokal shërbimi shtesë*”. Investitor: S. M. Sipërfaqja ndërtimore 104 m².

-Leje ndërtimi nr. 910, datë 28.10.2013 për objektin: “*Ndërtim banesë me dy kate për zyra dhe për fjetje*”. Investitor: “B...b” shpk. Sipërfaqja ndërtimore 185 m².

-Leje ndërtimi nr. 1046, datë 11.12.2013 për objektin: “*Vaskë për dekantimin e ujërave të galerisë*”. Investitor: “B...b” shpk. Sipërfaqja ndërtimore 328 m².

-Leje ndërtimi nr. 909, datë 21.10.2013 për objektin: “*Banesë dy kate fjetje për nevojat personelit*”. Investitor: “B...b” shpk. Sipërfaqja ndërtimore 150 m².

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim e Zhvillimit Urbanistik në Bashkinë Pukë, të pezullojë dhënien e lejeve të përdorimit për këto 5 **leje zhvillimore** derisa investitorët të kenë zgjidhur më parë marrëdhëniet e pronësisë të truallit të objektit ndërtimor me dokument pronësi sipas kërkesave ligjore.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga ish Komuna Qerret, në vitin 2015, janë miratuar leje zhvillimore në dy raste:

-Leja zhvillimore me nr. 104, datë 16.04.2015, për objektin: “*Godinë shërbimesh 3 katë*”, në fshatin Karmë. Investitor: “B...d” shpk. Zhvillues i objektit: “M...j” shpk. Mungon vërtetimi mbi pronësinë e truallit të investitorit: “B...d” shpk.

-Leja zhvillimore me nr. 21 prot., datë 28.01.2015, për objektin: “*Magazinë frigoriferike frutash*”, në fshatin Gomsiqe. Investitor është Komuna Qerret. Zhvillues është subjekti: “A...x” shpk. Leja ndërtimore është miratuar mbi truall privat me sipërfaqe 400 m² me të cilin janë lidhur marrëdhënie kontraktuale. Nuk ka miratim nga Këshilli i Komunës për kryerjen e këtij investimi.

Vlera e investimit është 9,875,616 lekë, objekti ka përfunduar por nuk është vënë në funksionim prej dy vitesh çka përbën mos përdorimin me efektivitete të fondeve publike, në kundërshtim me nenin nr. 1 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i

ndryshuar dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Lejet zhvillimore, janë dhënë pa pasur marrëdhëniet e truallit të ndërtimit, pa pasur Plan Zhvillimi Urbanistik të miratuar dhe të pa konfirmuar nga Agjencinë Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar nenet 3, 7, 19, 32, ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, nenet 9, 39.

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim e Zhvillimit Urbanistik në Bashkinë Pukë, të pezullojë dhënien e lejes së përdorimit për objektin: “*Godinë shërbimesh 3 kate*”, me investitor “B...d” shpk derisa investitori të kenë zgjidhur më parë marrëdhëniet e pronësisë të truallit të objektit ndërtimor me dokument pronësi sipas kërkesave ligjore.

7.2.Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masat për të vënë në efencë investimin e kryer për objektin: “*Magazinë frigoriferike frutash*” duke rinegocuar dhe saktësuar detyrimet kontraktuale të lidhur datë 25.07.2014 me pronarin e truallit të objekti. Për këtë, të merret më parë miratimi në Këshillin e Bashkisë.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

8. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2015, Bashkia Pukë, ka financuar shoqërinë “F...T” sha sipas fondeve të miratuara me vendime të Këshillit të Bashkisë, në shumën 6,700,000 lekë. Shoqëria “F...T” sha ka për aktivitet sportin e futbollit, në të cilën Bashkia Pukë, ka qene aksionare me më pak se 50% e kapitalit, aktualisht është aksionare e vetme me 100% të kapitalit.

Në vitin 2016, Bashkia Pukë, ka financuar shoqërinë “F... T” sha në shumën 5.683.640 lekë, nga të cilat; transferime 3.045.000 lekë për shoqërinë “F...T” sha, kuotë anëtarësimi për Federatën Shqiptare të Futbollit, 1.064.000 lekë dhe akomodim, transport, dhe ushqime për sportistët në shumën 1.574.640 lekë.

Me sportistët janë lidhur kontrata tip me Bashkinë Pukë, në të cilat është përcaktuar si detyrim financiar, shpërblimi i sportistëve në shumën 40,000 lekë për çdo muaj, kontrata të cilat nuk janë zbatuar nga Bashkia Pukë pasi shpërblimi i sportistëve është bërë nga “Futboll Klub Tërbuna” sha.

Financimi i shoqërisë “F...T” sha nga Bashkia Pukë edhe në kushtet kur është aksionare me 100% të kapitalit, pa përcaktuar destinacionin e investimit, rritje kapitali apo sponsorizime, pa përcaktuar kuotat e trajtimit të sportistëve me vendim të Këshillit të Bashkisë, është shkelje e kërkesave të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 25, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” nenet 10/2, 40/2 dhe 76 si dhe të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, nenet 3, 4.

8.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, të përpilojë programe të qarta lidhur me financimin e aktiviteteve sportive veçanërisht të sportit të futbollit.

Të rishikojë, mundësinë e organizimit të këtij sporti në nivelin e shoqatave ose të klubeve sportive, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9376, datë 21.04.2005 “Për sportin” i ndryshuar.

Të miratojë me vendime të Këshillit të Bashkisë, kontratat tip të sportistëve si dhe destinacionin e fondeve dhe të auditojë përdorimin e tyre nga shoqëria “F...T” sha.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Ish Komuna Qerret ka pasur në administrim, automjetin e dhuruar nga shoqata “*T...a*”, Tip Sreyr-Punch me targa PU 1518 A, i pa vlerësuar në vlerë lekë dhe i pa dokumentuar akti i dhurimit. Nga Bashkia Pukë, nuk është regjistruar në kontabilitete dhe nuk është inventarizuar ky automjet.

Në këtë rast, mungesa e automjetit, **përbën dëm ekonomik** për Bashkinë Pukë, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. III pikat 26, 35/b, 35/c, Kap IV, pika 73 si dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

9.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masat, të identifikojë personat përgjegjës debitorë që e kanë pasur në ngarkim mjetin e transportit duke ndjekur inventarizimet në vite deri në origjinën e krijimit të asetit, të nxjerrë përgjegjësitë materiale deri në kallëzim penal për përvetësim prone shtetërore nga ish përdoruesin e mjetit apo ish titullarin e Komunës Qeret.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

10.Gjetje nga auditimi: Në vitin 2016, nga Bashkia Pukë, janë kryer shpenzime për ndërtimin e dy objekteve: “Mulli për bluarjen e drithërave” në vlerën totale 2,264,085 lekë nga të cilën njëri në fshatin Lumëz me vlerë 1,189,214 lekë dhe tjetri në fshatin Rrapë me vlerë 1,074,871 lekë, me qëllimin për tu ardhur në ndihme fermerëve të kësaj zone.

Këto objekte, megjithëse janë vënë në shfrytëzim, nuk është lidhur kontratë qiradhënie me personat që i administrojnë dhe i kanë në përdorim këto objekte dhe as nuk janë miratuar tarifa shërbimi, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar nenet 36, 54/e dhe ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, pjesa V, neni 662.

10.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masat, të administrojë këto asete sipas kërkesave ligjore publike duke lidhur kontrata qiradhënie me personat që i përdorin si dhe të miratojë tarifën e shërbimit, me vendim të Këshillit të Bashkisë.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Pavarësisht nga puna e bërë për arkëtimin e taksave dhe tarifave, në Bashkinë Pukë, deri më datën 31.12.2016 janë debitorë 222 subjekte në vlerën **12,954,698 lekë, prej tyre;** 31 subjekt në vlerën 7,235,652 lekë ose mbi 55% e vlerës së debitorëve, nuk kanë paguar për vitet 2011-2016, taksat dhe tarifën vendore, respektivisht; 23 subjekt të Biznesit Vogël në vlerën 2,982,264 lekë dhe 7 subjekte të Biznesit Madh në vlerën 4,252,888 lekë (madje 10 subjekte nuk kanë paguar që 5 vjet taksat dhe tarifën vendore)

Për periudhën 3 vjeçare 2013-2016 në Bashkinë Pukë nuk janë realizuar të ardhurat nga taksat dhe tarifën në vlerën **30,365,632 lekë**. Bashkia Pukë edhe pse ka mazhorancën e aksioneve në Ujësjellës sh.a Pukë dhe për vitin 2016 kanë pasur përfaqësues në Këshillin Administrativ të krijuar kohët e fundit, ndërkohë nuk ka mundur të lidhjen e një marrëveshje, në të cilën Ujësjellësi sh.a. Pukë të përcaktohet si agjent tatimor, për arkëtimin e taksave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, marrëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për Bashkinë Pukë.

11.1. Rekomandimi: Nga Zyra e Taksave të Bashkia Pukë, të merren masa për regjistrimin në kontabilitet si debitorë, të krijohet regjistri elektronik, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **12,954,698 lekë**, duke bërë njoftim vlerësimet tatimore, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe konkretisht:

Pavarësisht kërkesave të mëparshme duke i rikërkuar vazhdimisht dhe ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

b. Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në R.SH" të ndryshuar.

c. Zyra e taksave për mos pagesën e taksave në afat të aplikojë dënim me gjobë për pagesat e vonuara, në masën 0,06% kamat vonesë për çdo ditë vonesë por jo më tepër se 365 ditë, bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, dt. 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014.

d-edhe pas njoftimeve zyrtare në se Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite nga ana e Bashkisë (Drejtoria e Taksave dhe Drejtoria Juridike), të merren masa administrative (llogaritje kamat vonesave) apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet bërë kallëzim penal pranë organit të Prokurorisë, siç përcaktohet në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008" Për Procedurat tatimore në R.SH" ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

d –Zyra e taksave në Bashkinë Pukë dhe 4 Njësitë administrative të listojnë në mënyrë elektronike abonentët familjarë debitorë për taksën tokës nga fermerët dhe taksat e popullatës, duke njoftuar tatimpaguesit familjarë me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifrat etj, në kundërshtim me pikën 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016".

11.2. Rekomandimi: Bashkia Pukë të përgatisë aktmarrëveshjen me Ujësjellës sh.a. Pukë, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Pukë, u konstatua se nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, për subjektet e pajisura me leje minerare apo koncesionare, për pasojë nuk janë lidhur kontrata dypalëshe, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor", pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor". i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016.

(Lista e subjekteve të pajisura me Lejë Minerare dhe Koncesionare paraqiten në Aneksin nr 1 bashkëlidhur).

12.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, nëpërmjet strukturave të saj dhe zyra e administrimit të pyjeve e kullotave, të marrë masa për lidhjen e kontratave të qirasë duke vendosur edhe penalitetet përkatëse, me subjektet e pajisur me leje minerare për shfrytëzim gurore dhe të kërkojë arkëtimin e të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë, sipas aneksit bashkëngjitur Projekt Raportit të Auditimit. VKM 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për

paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor” i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Në 5 investimet e audituara në bashkinë Pukë, “Ndërtim Palestre pranë shkollës Sabah Sinani dhe Migjeni”, “Investim në fasada, trotuar dhe ndriçim, Rikonstruksion i qendrës Luf”, “Rigjenerimi i Shëtitores Qendër Pukë”, “Sistemim i lagjes pas pallatit të kulturës” dhe “Rikonstruksion i çatisë së shkollës Bushat” me vlerë totale të kontratave 209,984,833 lekë pa t.v.sh nga verifikimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjet teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në katër prej tyre në vlerën 7,035,727 lekë pa t.v.sh si dhe mangësi në dokumentacion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Vendimin Nr. 514 të Këshillit të Ministrave, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 9 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 4, paragrafi 4.

13.1. Rekomandim: Nga Bashkia Pukë, të merren masa për monitorimin e vazhdueshëm të investimeve, si gjatë periudhës së zbatimit të punimeve ashtu edhe në përfundim të tyre. Dosjet teknike të objekteve të përfunduara të merren në dorëzim nga zyra e autorizuar sipas Rregullores së Brendshme të Bashkisë vetëm pas plotësimit të tyre në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, pika, 4 paragrafi 4.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 181/8 prot., datë 29.05.2015 dhe të ri kërkuara për zbatim me shkresën nr. 1015/61 prot., datë 5.04.2016, u konstatua se:

Nga **7 masa organizative** të rikërkuara, janë zbatuar 4 masa, pa zbatuar janë 2 masa ndërkohë është në proces zbatimi 1 masë organizative.

-Nga **2 masa të rikërkuara për shpërblimin e dëmit** në shumën 302,141 lekë nga 24 persona e subjekte, është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim duke arkëtuar shumën 181,589 lekë nga 17 persona, është pa zbatuar 1 masë, pa arkëtuar shuma 120,552 lekë nga 7 persona.

-Nga **4 masa disiplinore të rikërkuara, “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e kontratës së Punës”**, nuk është zbatuar asnjë masë disiplinore për punonjësit:

-**B. A.**, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve, **F. B.**, Përgjegjëse e Sektorit të Financës aktualisht inspektore e financës, **A. S.**, ish-përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe **I. K.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Prokurimit me Vlera te Vogla, aktualisht Drejtor Juridik.

Nga **4 masa gjorbë të vendosura nga APP** për shumën 170,000 lekë, është arkëtuar shuma 120,000 lekë nga 3 persona, mbetet pa arkëtuar shuma 50,000 lekë nga 1 person.

14.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të ri kërkuara me shkresën nr. 1015/61 prot., datë 5.04.2016, në

zbatim të kërkesave ligjore.

Të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit të pa arkëtuar në shumën 120,552 lekë dhe vlerën e gjobës të vendosur nga APP në shumën 50,000 lekë, duke bërë kërkesë padi në Gjykatë ndaj subjekteve debitorë.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike dhe nga verifikimi në terren, u konstatua se për objektin: “*Sistemim i lagjes pas pallatit të kulturës*” Pukë, janë paguar punime të pa kryere në vlerën **1,589,890 lekë pa t.v.sh.**

Punimet nuk kanë përfunduar sipas kushteve të kontratës dhe objekti nuk është marrë në dorëzim nga Bashkia Pukë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 622/16 prot., datë 14.06.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Pukë dhe OE “A...N” sh.p.k si dhe kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. 1068/4, datë 07.06.2016.

15.1. Rekomandim: Nga Bashkia Pukë, të merren masa që subjekti “A...N” sh.p.k, të plotësojë punimet e pa kryera të konstatuara nga grupi i auditivit, porsa kohë që kontrata nuk ka përfunduar. Nëse nuk arihet kjo dakortësi, vlera 1,589 mijë lekë të zbritet nga situacioni i fundit.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 13,741,642 lekë**, i më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Me subjektin: “G...” shpk, është lidhur nga Bashkia Pukë, kontrata me nr. 1688/9 prot., datë 24.10.2016 me objekt: “*Shfrytëzim i lëndës drusore për dru zjarri e lëndë punimi nga pyjet*”, për periudhën 24.10.2016 deri më datën 24.10.2017, me vlerën të kontratës 4.744.560 lekë me tvsh.

Sipas kushteve të kontratës, detyrimet financiare janë parashikuar me këste dhe pagesat nuk janë kushtëzuar nga sasia e lëndës drusore në momentin e maturimit të këstit të pagesës.

Nga të dhënat e paraqitura nga Zyra e Taksave Bashkia Pukë, rezulton se aktualisht nga subjekti: “G...” shpk, nuk janë paguar detyrimet kontraktuale **për 3,573,470 lekë me dëm ekonomik**, nga të cilat 28,970 lekë vlera e penalitetit të llogaritur.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masa, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimit të kontratës në vlerën **3,573,470 lekë**, në zbatim të kushteve të kontratës, në të kundërtën të kërkohet ekzektimin e kontratës në rrugë gjyqësore.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Investim në fasada, trotuar dhe ndriçim, Rikonstruksion i qendrës Luf” Pukë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **1,904,196 lekë pa tvsh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt si dhe mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **1,411,136 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 110/1 prot., datë 22.06.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Pukë dhe OE “J...K” sh.p.k, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. 1115/4 prot., datë 16.06.2016.

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Pukë, të merren masa për arkëtimin e vlerës **3,315,332 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “J...K” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 110/1 prot., datë 22.06.2016 me objekt: “Investim në fasada, trotuar dhe ndriçim, Rikonstruksion i qendrës Luf” Pukë, nga të cilat vlera 1,904,196 lekë përse është paguar për punime të pa kryera dhe 1,411,136 lekë penalitet i llogaritur.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim Palestre pranë shkollës Sabah Sinani dhe Migjeni” Pukë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **1,455,172 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt si dhe mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **88,227 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 175/18 prot., datë 16.09.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Pukë dhe OE “A...J” sh.p.k, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. 1595/4 prot., datë 16.09.2016.

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Pukë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,543,399 lekë** nga operatori ekonomik: “A...J” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 175/18 prot., datë 16.09.2016 me objekt: “Ndërtim Palestre pranë shkollës Sabah Sinani dhe Migjeni” Pukë, nga të cilat vlera 1,455,172 lekë për punime të pa kryera dhe 88,227 lekë penalitet i llogaritur.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Gjegjan, në vitin 2013 janë miratuar dhënia e 5 lejeve ndërtimore për të cilat nuk janë llogaritur saktë dhe nuk janë arkëtuar detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë në shumën totale **për 1,181,201 lekë me dëm** ekonomik për buxhetin e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 27, dhe UKM nr. 1, datë 8.5.2013 “Për llogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit të banesave për vitin 2013”, sipas objekteve:

-Leje ndërtimi nr. 935 prot., datë 7.11.2013 për objektin: “Lokal shërbimi”. Investitor: N. L. Sipërfaqja ndërtimore 58 m². Vlera e pa paguar 24,821 lekë.

-Leje ndërtimi nr. 436, datë 23.04.2013 për objektin: “Lokal shërbimi shitesë”. Investitor: S. M. Sipërfaqja ndërtimore 104 m². Vlera e pa paguar 17,955 lekë.

-Leje ndërtimi nr. 910, datë 28.10.2013 për objektin: “Ndërtim banesë me dy kate për zyra dhe për fjetje”. Investitor: “B...b” shpk. Sipërfaqja ndërtimore 185 m². Vlera e pa paguar 807,837 lekë.

-Leje ndërtimi nr. 1046, datë 11.12.2013 për objektin: “Vaskë për dekantimin e ujërave të galerisë”. Investitor: “B...b” shpk. Sipërfaqja ndërtimore 328 m². Vlera e pa paguar 220,671 lekë.

-Leje ndërtimi nr. 909, datë 21.10.2013 për objektin: “Banesë dy kate fjetje për nevojat personelit”. Investitor: “B...b” shpk. Sipërfaqja ndërtimore 150 m². Vlera e pa paguar 109,917 lekë.

4.1.Rekoamandimi: Bashkia Pukë, të kërkojë në rrugë ligjore nëpërmjet dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë apo ZVRPP, për arkëtimin e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë në shumën **1,181,201 lekë** respektivisht nga personat dhe subjektet e mëposhtëm:

a-N. L. për shumën 24,821 lekë,

b-S. M. për shumën 17,955 lekë,

c-“B...b” shpk për shumën 1,138,425 lekë.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

5.Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të paraqitura nga Bashkia Pukë rezultojnë se janë pajisur me leje minerare dhe koncesionare 7 subjekte, nga të cilat deri më datën 31.12.2016 nuk kanë paguar taksat vendore 2 subjekte në vlerën prej **1,060,918 lekë me dëm ekonomik, respektivisht:**

a.Subjekti “D...1” shpk me NUIS J78716317N me pronare; P. M., leje minerare nr. 1717, datë 09.06.2012 me aktivitet: “shfrytëzim gurorë” me afat 5 vjeçar sipas kontratës lidhur më datën 04.10.2012 deri 04.10.2017, për sipërfaqen prej 0,2 ha, duhet të paguante vlerën prej 1,056,888 lekë, ka paguar deri më datën 31.12.2016 vlerën 649,612 lekë, mbetet debitor edhe për vlerën **407,276 lekë**.

b.Subjekti “ B...b” sha me NUIS K13107002A me pronar; M. N., leje minerare nr. 1549, datë 12.12.2012 me aktivitet: “shfrytëzim nxjerrje krom” me afat 10 vjeçar sipas kontratës lidhur më datën 03.02.2015 deri 03.02.2025 për sipërfaqen prej 0,8 ha duhet të paguante vlerën prej 653,642 lekë, ka paguar deri më datën 31.12.2016 vlerën 0 lekë, mbetet debitor edhe për vlerën **653,642 lekë**.

5.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masa, të ndjekë procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **1,060,918 lekë**, respektivisht nga subjekti “D...i” shpk në vlerën **407,276 lekë** dhe Subjekti “ B...b” sha në vlerën **653,642 leke**

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: Janë kryer shpenzime për sponsorizimin e shoqatave të ndryshme në **shumën totale 580,000 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore, nga të cilat:

-Në ish Komunën Gjegja, për 3 shoqata në 4 raste për **vlerën 80,000 lekë**, nga të cilat në vitin 2014 për 60,000 lekë dhe në vitin 2015 për 20,000 lekë.

Në ish Komuna Qerret, për shoqatën “T...a” në 3 raste për **vlerën 500,000 lekë**, nga të cilat në vitin 2013 për 200.000 lekë, në vitin 2014 për 150.000 lekë dhe viti 2015 për 150.000 lekë.

Xhirimi i fondeve publike fondacioneve të mësipërme, në vlerën 580,000 lekë, pa zhvilluar procedura prokurimi, (pavarësisht nga Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe marrëveshjet të nënshkruara nga ish kryetari i Komunës Qerret), është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar -**Neni 4-Fusha e zbatimit, përcaktohet se;** Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5,6,7,8 e 9 të këtij ligji që rregullohen me ligj tjetër.

Sponsorizimet janë bërë pa lidhur me këto shoqata, marrëveshje bashkëpunimi ku të jenë përcaktuar detyrimet reciproke, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7892, datë

21.12.1994 “Për sponsorizimet” i ndryshuar nenet 3, 4 dhe ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, neni 18.

6.1.Rekomadimi: Bashkia Pukë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **580,000 lekë** nga urdhëruesit e shpenzimeve;

- N. C. me detyrë ish kryetar i Komunës Gjegjan, për vlerën 40,000 lekë,
- M. F. me detyrë ish P/Financës në Komunën Gjegjan, për vlerën 40,000 lekë,
- R. D. me detyrë me detyrë ish Kryetar i Komunës Qerret, për vlerën 250,000 lekë,
- P. F. me detyrë ish P/Financës Komuna Qerret, për vlerën 250,000 lekë.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës të prokurimit me objekt “Ndërtim palestre pranë shkollës mesme “Sabah Sinani”, rezultoi vlera **435,000 lekë dëm ekonomik**, pasi subjekti “A...j” shpk në preventiv zërin “Makineri dhe Pajisje” e ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, duke përfshirë pajisjet pa ndarë vlerën e montimit dhe vlerën e pajisjeve pa tvsh, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, për rrjedhojë kjo vlerë është përfituar tepër .

7.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë të arkëtojë vlerën **435,000 lekë** përfituar tepër nga subjekti “A...j” shpk në objektin “Ndërtim palestre pranë shkollës mesme “Sabah Sinani”.

Menjëherë

8.Gjetje nga auditimi: Janë kryer shpenzime audiovizive, intervista dhe reportazhe në “T...” **gjithsej 429,750 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e Njësisë së Qeverisjes Vendore, pa pasur dokumentacionin e nevojshëm ligjor; nuk ka akt marrje në dorëzim të shërbimit dhe faturat nuk është e firmosur nga ndonjë përfaqësues i Komunës, shkelje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-40. Shpenzimet janë kryer:

-Në vitin 2015, nga ish Komuna Gjegjan, **për vlerën 251,500 lekë**, në vitin 2013, nga ish Komuna Qerret, **për vlerën 78,250 lekë** dhe në vitin 2014, nga ish Komuna Qelëz, **për vlerën 100,000 lekë**.

Pagesat e mësipërme në vlerën **429,750 lekë**, vetëm nëpërmjet lidhjes së kontratave, janë bërë në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëpunimin e programeve atë reklamave për transmetimin nga Operatorët Radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore” **pasi;**

-nuk janë përzgjedhur organet e masmedias, në kundërshtim me pikën 7, të VKM të mësipërm, *ku përcaktohet se: Në vartësi të llojit të programit, reklamës apo spotit, kushtet e veçanta, për përzgjedhjen e organeve të masmedias/agjencive të specializuara janë:*

a) *organi i masmedias, agjencia e specializuar(ndërkombëtar/ e ,kombëtar/ e , vendor.*

b) *çmimi i ofruar nga organi i masmedias /agjencia e specializuar.*

c) *koha e transmetimit.*

-nuk është krijuar komision për ndjekjen e procedurave dhe hartimin e dokumenteve, në kundërshtim me pikën 8 të VKM të mësipërm ku përcaktohet se: *Komisioni për ndjekjen e procedurave dhe hartimin e dokumenteve përbëhet nga 5 antarë,3 prej tyre specialistë të fushës.*

-nuk u është shpërndarë organeve të masmedias/agjencive të specializuara ftesë për negociata, etj., në kundërshtim me pikën 9 të VKM të mësipërm, *ku përcaktohet se: Komisioni,brenda një periudhe kohore 5-ditësh nga data e daljes së urdhrorit, u shpërndan, me korrespondencë zyrtare organeve të masmedias/agjencive të specializuara ftesën për negociata. Ftesa për negociata publikohet edhe në faqen e internetit të Institucionit.*

-në kushtet kur nuk është krijuar komisioni, nuk mund të flitet për hartimin e një raporti të hollësishëm për të gjitha procedurat e ndjekura, të cilin duhet ti paraqiste titullarit para lidhjes së kontratës, në kundërshtim me pikën 13 të VKM të mësipërm (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **429,750 lekë** nga përfituesi; “T...”, për vlerën **429,750 lekë**.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

9.Gjetje nga auditimi: Në vitin 2013, nga ish Komuna Qelëz, është paguar subjekti: “R...n” shpk për blerjen e projektit: “Rikonstruksion i rrugës Katund + Kishës” **në shumën 400,000 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore. Këto shpenzime janë kryer pa pas akt marrje në dorëzim të projektit dhe fatura e blerjes, nuk është e firmosur nga ndonjë përfaqësues i Komunës, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-40.

9.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **400,000 lekë** nga përfituesi subjekti “R...n” shpk.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

10.Gjetje nga auditimi: Janë paguar shpenzime për telefonin celular gjithsej **385,485 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e Njesisë së Qeverisjes Vendore nga të cilat;

-Për ish Kryetarin e Komunës Gjegjan, N. C. në shumën **181,556 lekë**, për ish Kryetarin e Komunës Qerret, R. D. në shumën **185,907 lekë** dhe për ish P/Zyrës së financës Komuna Qerret P. F. në shumën për **18,022 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër celulari të personave juridikë, publikë”, pikat 1, 8, 9.

10.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **385,485 lekë** nga përfituesi;

-N. C., me detyrë ish Kryetar i Komunës Gjegjan për vlerën 181,556 lekë,

-R. D., me detyrë ish Kryetar i Komunës Qerret për 185,907 lekë,

-P. F., me deyre ish P/Financës Komuna Qerret për 18,022 lekë.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

11.Gjetje nga auditimi: Në vitin 2015, nga ish Komuna Gjegjan, është paguar subjekti “E...i” shpk në **shumën 358,800 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore, për ndërtim linje TM për furnizim me energji elektrike fshati Kalivarë.

Për këtë shpenzim, është urdhër prokurimi nr. 16, datë 22.04.2015, por mungon dokumentacioni i nevojshëm ligjor; nuk ka preventiv për punimet që do të kryhen, nuk ka situacion të punimeve dhe as akt marrje në dorëzim të punimeve. Fatura nuk është firmosur nga komisioni ose person tjetër përfaqësues të ish Komunës Gjegjan, shkelje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-40.

11.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për *arkëtimin e vlerës 358,800 lekë* nga përfituesi subjekti “E...i” shpk.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dhënies me qira të objekteve të Bashkisë Pukë u konstatua se subjekti “D...1” P. M. Luf Pukë nuk ka shlyer detyrimin e kontratës të lidhur datë 4.10.2012, për qiranë e vitit 2016 në vlerën **99,000 lekë**. Gjithashtu nuk ka shlyer taksat vendore të vitit 2016 për vlerën **121,992 lekë**.

12.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **220,992 lekë**, nga subjekti “D...1” P. M. Luf Pukë, për mos shlyerje detyrim qiraje dhe taksa

vendore të vitit 2016, nga të cilat 99,000 lekë vlera e qerasë së pa paguar dhe 121,992 lekë, detyrimet për taksat vendore.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikonstruksion i çatisë së shkollës Bushat*” Pukë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **177,297 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 13.11.2013 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor ish- Komuna Qelëz dhe OE “*A...L*” sh.p.k si dhe kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. 163, datë 26.11.2013.

13.1. Rekomandim: Nga Bashkia Pukë, për ish-Komunën Qelëz, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **177,297 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “*A...L*” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 13.11.2013 me objekt “*Rikonstruksion i çatisë së shkollës Bushat*” Pukë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2014, nga ish Komuna Qerret, janë kryer në 2 raste shpenzime për pritje dhe përcjellje në **shumën 80,000 lekë, me dëm me dëm ekonomik** për buxhetin e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore. Këto shpenzime janë kryer pa pasur program të miratuar, nuk ka listë emërore të përfituesve, nuk ka procesverbal të komisionit të blerjeve dhe shërbimeve me vlera të vogla për kryerjen e këtij shpenzimi, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” i ndryshuar pikat 7, 8, 12 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-40.

14.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **80,000 lekë** nga urdhëruesit e shpenzimeve;

-R. D. me detyrë ish Kryetar i Komunës Qerret për vlerën 40,000 lekë,

-P. F. me detyrë ish P/Zyrës së Financës Komuna Qerret për vlerën 40,000 lekë.

Brenda Muajt Dhjetor 2017

B/1. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

-Në procedurat e prokurimeve me tender, u konstatuan **në 1 raste për vlerën 9,875,616 lekë** mos përdorimi me efektivitet të fondeve publike, nga të cilat:

Komuna Qerret

Nga auditimi rezultoi se është konstatuar vlera **9,875,616 lekë** mos efektivitet në 1 investim publik, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Komuna Qerret në vitin 2014-2015 ka realizuar një investim me objekt “*Pistë+Magazinë Frigoriferike për fruta*”, i cili mbi 2 vjet nuk shfrytëzohet, pra objekti nuk është në funksion të qëllimit të ndërtimit tij, çka ka shkaktuar vlerën 9,875,616 lekë mos efektivitet të fondeve publike, në kundërshtim me nenin nr. 1 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

1.1 Rekomandimi: Bashkia Pukë të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për mungesën e efikasitetit të fondeve publike në vlerën 9,875,616 lekë në objektin “*Pistë+Magazinë Frigoriferike për*

fruta Njësia Administrative Qerret” si dhe të marrë masa për shfrytëzimin e objektit duke nxjerrë të ardhura nga përdorimi i saj ose nga qiradhënia.

B/2. SHPENZIME NË FUSHËN E PROKURIMEVE, ME IMPAKT NEGATIV NË BUXHET:

Në auditimin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në Bashkinë Pukë, u konstatua se 3 procedura prokurimi, janë kryer në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe pika 5 e nenit 53 “Shqyrtimi i ofertës”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, *pasi*:

Operatorët ekonomikë, janë shpallur fitues edhe **pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST**, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor, duke mos anuluar këto procedura, veprime me impakt negativ në buxhet për vlerën **37,825,255 lekë**, duke favorizuar operatorët ekonomik në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit dhe shpallur fitues me kriteret të pa plota, konkretisht:

1. Në prokurimin publik me objekt: **“Rikonstruksion qendra Luf”**, me fondin limit 14,166,666 lekë pa tvsh, zhvilluar datë 29.04.2016 në të cilën është shpallur fitues OE “J...u” shpk me vlerë të kontratës **12,671,689 lekë** pa tvsh, KVO, ka zgjedhur ofertën fituese, në kundërshtim me nenet 53/4 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61/2 dhe 14/5.

2. Në prokurimin me objekt: **“Sistemim, asfaltim i lagjes pas pallatit Kulturës, 2016”**, me fondin limit 23,658,589 lekë pa tvsh, zhvilluar datë 3.05.2016, në të cilën është shpallur fitues OE “A...n” shpk me vlerë të kontratës **23,049,590 lekë** pa tvsh, KVO ka zgjedhur ofertën fituese në kundërshtim me nenet 1, 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 14/5, 15/5, 61/2, 73

3. Nga auditimi i procedurës të prokurimit me objekt **“Shërbime, lyerje, riparime në objektet në vartësi të Bashkisë Pukë, 2015”**, ka rezultuar vlera **215,889 lekë** (2,846,000 - 2,630,111), si diferencë midis 2 OE, të cilët paraqesin mos plotësim të kriterëve të kualifikimit dhe KVO padrejtësisht ka shpallë fitues OE “D...x” shpk me vlerën më të lartë 2,846,000 lekë në vend të BOE “A...l” shpk & “A...x”, i cili paraqet ofertën më të ulët 2,630,111 lekë, në kundërshtim me nenet 1, 46, 53 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 14/5, 73.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe të shpalljes fitues të operatorëve në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative të pa mundur për llogaritje.

C. MASA DISIPLINORE:

C-I. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në shkronjën (c) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “b” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronja **k** të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” **i rekomandojmë Kryetarit të**

Bashkisë, që ti kërkojë Komisionit disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

“Vërejtje”, parashikuar në nenin 58, shkronja “a” **për 1 punonjës** si më poshtë:

1-zj. F. B. me detyrë ish P/Zyrës së Financës për periudhën 1 Janar 2015 deri më datën 1 Gusht 2015, aktualisht specialistë në zyrën e financës Bashkia Pukë, pasi:

-Në vitin 2015, ka lejuar që Bashkia Pukë, ka financuar “F...” sha, ku bashkia është aksionare, në shumën 6.700.000 lekë, pa pasur vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë “F...” sha, për ndryshim të % së aksioneve për Bashkinë Pukë dhe pa pasur miratim me vendim të Këshillit të Bashkisë për ndryshimin e raportit të aksioneve në shoqërinë “F...” sha.

Në këtë rast, financimi i shoqërisë “F...” sha është në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 25, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” nenet 10/2, 40/2 dhe 76 si dhe të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, nenet 3, 4

C-II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës

Mbështetur në shkronjën (c) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore si më poshtë:

a. “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës” për 4 punonjësit e mëposhtëm:

1-z. G. G. me detyrë ish P/Urbanistikës Komuna Qerret, aktualisht me detyrë specialist në Drejtorinë e Zhvillimit Urban në Bashkinë Pukë, pasi:

Në cilësinë e ish P/Urbanistikës në ish Komunën Qerret, ka miratuar dhënien e lejes së ndërtimit me nr. 104, datë 16.04.2015 për objektin: “*Godinë shërbimesh 3 kate*” në fshatin Karmë. Afati kohor 16.04.2016, investitor “B...d” shpk, zhvillues i objektit: “Mjekaj Grup” shpk., miratimi i kësaj leje, është bërë pa pasur plan urbanistik të miratuar.

Nuk janë mbajtur akte kontrolli mbi zhvillimin e objektit të ndërtimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, neni 42.

2-zj. F. P. me detyrë P/Financës në Bashkinë Pukë për periudhën nga 1 Gushti 2015 e në vazhdim si dhe ish P/Zyrës së financës në ish Komunën Qelëz, pasi:

Nuk janë administruar me inventar fizik projektet dhe studimet e financuara sipas vlerës llogarisë të aktivitetit të bilancit 202 “*Shpenzime për studime ose kërkime*”, për vlerën e debisë 10,015,337 lekë.

Për këto aktive, **nuk janë hapur kartela inventariale** për personat që i kanë në ngarkim dhe i administrojnë këto studime dhe projekte, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73.

Llogari 212 “*Ndërtime e konstruksione*”, për vlerën e debisë 557,092,063 lekë, nuk është e sistemuar në të gjitha rastet në shtesë të vlerës për vlerën e objekteve të rikonstruara, në

kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Në vitin 2015, ka lejuar që Bashkia Pukë, ka financuar “F...” sha, ku bashkia është aksionare, në shumën 6.700.000 lekë, pa pasur vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë, për ndryshim të % së aksioneve për Bashkinë Pukë dhe pa pasur miratim me vendim të Këshillit të Bashkisë për ndryshimin e raportit të aksioneve në shoqërinë “F...” sha.

Në këtë rast, financimi i shoqërisë “F...” sha është në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 25, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” nenet 10/2, 40/2 dhe 76 si dhe të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, nenet 3, 4.

-Për vitin 2016, në Bashkinë Pukë, ka kryer aktivitetin e vet sportiv subjekti “F...” sha me NIPT L19704301F, me kapital 100% të Bashkisë Pukë.

Subjekti “Futboll Klub Tërbuni” sha, nuk është vetë financuar bazuar në statusin e saj juridik dhe në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Për këtë vit, nga Bashkia Pukë, janë bërë shpenzime për financimin e aktivitetit të subjektit “F...” sha, gjithsej 5.683.640 lekë sipas miratimit me vendim të këshillit të bashkisë.

Kuotat për trajtimin ushqimor dhe akomodimin e sportistëve, nuk janë miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë Pukë dhe as me vendim të Bordit të Shoqërisë “F...” sha, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar nenet 8, 9, 22, 25, 40, 54, ligjit nr. 9376, datë 21.04.2005 “Për sportin” i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

-Në vitin 2014, në ish Komunën Qelëz, është paguar “T...” në dy raste për shumën 100,000 lekë, pa pasur dokumentacionin e nevojshëm ligjor, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-40.

3-z. Gj. F. me detyrë P/Seksionit të Pyjeve në Bashkinë Pukë dhe

4- z. A. H. me detyrë specialist në Drejtorinë e Zhvillimit Rural Bashkinë Pukë, pasi:

Nga Bashkia Pukë, nuk janë ngritur komisionet përkatëse për marrjen në dorëzim të pyjeve dhe kullotave që kanë kaluar në pronësi sipas VKM nr. 433, datë 8.06.2016, **duke përcaktuar në terren statusin juridik aktual të tyre** si dhe për regjistrimi në pronësi pranë ZVRPP të gjitha pyjeve dhe kullotave, veprime në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar neni 7.8, ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, neni 5, ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1.2 dhe neni 27 pika 5, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, **kap. III**, pika 20, 21, 22, 30 dhe pika 35/a dhe VKM nr. 22, datë 9.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të administrimit të pyllit komunal” pikat 4, 5, 8.

-Nuk kanë marrë masat e nevojshme për zbatimin e kushteve të kontratës me nr. 1688/9 prot., datë 24.10.2016 me objekt: **“Shfrytëzim i lëndës drusore për dru zjarri e lëndë punimi nga pyjet”**, lidhur me subjektin “G...e” shpk, me afat për periudhën 24.10.2016 deri më datën 24.10.2017, me vlerën totale të kontratës për 4.744.560 lekë me tvsh.

Nuk është arkëtuar detyrimi i kontratës dhe penalteti i llogaritur për vlerën 3,573,470 lekë.

Personat e mësipërm, me veprimet apo mos veprimet e tyre, kanë shkelur kërkesat ligjore të trajtuara hollësisht në Raportin e Auditimit.

C-III. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Pukë (Sektor i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionarin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D.1. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV)

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Pukë t'i **kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë, për 1 mbikëqyrës të punimeve**, si më poshtë:

1. **Z. I. D.** në masën **100,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara me pasojë dëm ekonomik në vlerën **5,315,031 lekë pa tvsh nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve** në objektet:

a. "*Investim në fasada, trotuar dhe ndriçim, Rikonstruksion i qendrës Luf*", me sipërmarrës punimesh OE "*J...K*" sh.p.k, kontrata nr. 110/1 prot., datë 22.06.2016 për vlerën 15,206,027 lekë me tvsh, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 1,904,196 lekë pa tvsh; Mos aplikimin e penaltetit për *Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve* në vlerën 1,411,136 lekë pa tvsh; si dhe Mangësitë në dokumentacion;

b. "*Sistemim i lagjes pas pallatit të kulturës*", me sipërmarrës punimesh OE "*A...N*" sh.p.k, kontrata nr. 622/16 prot., datë 14.06.2016 për vlerën 27,659,507 lekë me tvsh, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 1,589,890 lekë pa tvsh; Mos aplikimin e penaltetit për *Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve* në vlerën 409,809 lekë pa tvsh; si dhe Mangësitë në dokumentacion.

Menjëherë

D2. Masa Administrative për Agjencinë e Prokurimit Publik

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2014, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj 20 punonjësve nga të cilët 3 Titullarë të AK, 7 punonjës në nivel Drejtorë dhe 10 punonjës si më poshtë:**

I. Bashkia Pukë për 9 persona, si më poshtë:

Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj **Titullarit të Autoritetit Kontraktor** të Bashkisë Pukë, konkretisht:

1. z. G. G., në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor të Bashkisë Pukë, për arsyet e mëposhtme:

-për mos marrjen e masave për shkeljet e konstatuara në 2 procedura prokurimi me efekte financiare për vlerën 5 milion lekë, mos efektivitet në përdorimin e fondeve publike, përkatësisht në tenderin me objekt: “Rikonstruksion qendra Luf 2016” dhe në tenderin “Sistemim, asfaltim i lagjes pas pallatit Kulturës 2016”.

-për lejimin e shpalljes fitues të ofertës me vlerë më të lartë në 2 raste, përkatësisht në tenderin “Shërbime, lyerje, riparime në objektet 2015” me efekte financiare për vlerën 0,2 milion lekë dëm ekonomik dhe në tenderin “Rigjenerimi i shëtitores Bashkia Pukë, 2016”.

Veprime në kundërshtim me nenin 12, 24 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, me nenin 1, 73 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” etj.

Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj anëtarëve të **Njësisë të Prokurimit** të Bashkisë Pukë, konkretisht:

2. E. K., në cilësinë e kryetarit të Njësisë të Prokurimit, për shkeljet **në 4 procedurat** e prokurimit në objektet: “Rigjenerimi i shëtitores Bashkia Pukë”, “Rikonstruksion qendra Luf”, “Sistemim, asfaltim i lagjes pas pallatit Kulturës” dhe “Ndërtim palestere pranë shkollës mesme Sabah Sinani”,

3. L. B., në cilësinë e anëtarit të Njësisë të Prokurimit, për shkeljet **në 2 procedurat** e prokurimit në objektet: “Rigjenerimi i shëtitores Bashkia Pukë” dhe “Ndërtim palestere pranë shkollës mesme “Sabah Sinani”,

4. M. P., në cilësinë e anëtarit të Njësisë të Prokurimit, për **shkeljet në 4 procedurat** e prokurimit në objektet: “Rigjenerimi i shëtitores Bashkia Pukë”, “Rikonstruksion qendra Luf”, “Sistemim, asfaltim i lagjes pas pallatit Kulturës” dhe “Ndërtim palestere pranë shkollës mesme “Sabah Sinani”,

Për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:

-Për vendosjen e disa kushteve dhe kriterëve të kualifikimit të pa argumentuara dhe me 2 standarde, në procedurën e prokurimit me objekt “Rigjenerimi i shëtitores Bashkia Pukë, 2016”, tek kriteri “kapaciteti teknik”, ku kërkohen periudha të ndryshme për sigurimet shoqërore si dhe periudha të ndryshme për eksperiencën në punë, për stafin tekniko-inxhinier

dhe fuqinë punëtore, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar neni 45 dhe 46, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 28 dhe neni 61/2 etj.

-Për vendosjen e disa kushteve dhe kriterëve të kualifikimit të cingjara dhe të me 2 standarde në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion qendra Luf” dhe “Sistemim, asfaltim i lagjes pas pallatit Kulturës”, të cilat kanë ndikuar në vlerësimin e operatorëve ekonomik.

-Për vendosjen e disa kriterëve të kualifikimit të ekzagjeruar në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim palestere pranë shkollës mesme “Sabah Sinani” Bashkia Pukë për vitin 2016”.

Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj anëtarëve të **Komisionit të Vlerësimit të Ofertave** të Bashkisë Pukë, konkretisht:

5. A. Z., në cilësinë e kryetarit të KVO, për shkeljet në 5 procedurat e prokurimit në objektet: “Rigjenerimi i shëtitorës Bashkia Pukë 2016”, “Rikonstruksion qendra Luf 2016”, “Sistemim, asfaltim i lagjes pas pallatit Kulturës 2016”, “Shërbime, lysterje, riparime në objektet në vartësi të Bashkisë Pukë 2015” dhe “Ndërtim 2 mullinjte me ujë në fshatrat Lumzi e Rrype 2016”.

6. E. S., në cilësinë e antarit të KVO, për shkeljet në 2 procedurat e prokurimit në objektet: “Rigjenerimi i shëtitorës Bashkia Pukë 2016” dhe “Ndërtim 2 mullinjte me ujë në fshatrat Lumzi e Rrype 2016” si dhe në cilësinë e anëtarit të Njësisë të Prokurimit në 2 procedura “Rikonstruksion qendra Luf 2016” dhe “Sistemim, asfaltim i lagjes pas pallatit Kulturës”.

7.A. K., në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkeljet në 3 procedurat e prokurimit në objektet: “Rigjenerimi i shëtitorës Bashkia Pukë 2016”, “Rikonstruksion qendra Luf 2016”, “Sistemim, asfaltim i lagjes pas pallatit Kulturës 2016”.

8. E. Ç., në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkeljet në 2 procedurat e prokurimit në objektet: “Blerje Automjete për mbetjet urbane, fadromë dhe makinë teknologjike 2016” dhe “Ndërtim 2 mullinjte me ujë në fshatrat Lumzi e Rrype 2016”.

9. R. G., në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkeljet në 2 procedurat e prokurimit në objektet “Rikonstruksion qendra Luf 2016” dhe “Sistemim, asfaltim i lagjes pas pallatit Kulturës 2016”.

Për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:

-Për vlerësimin dhe shpalljen fituese të ofertës me vlerën më të lartë, në procedurën e prokurimit me objekt “Rigjenerimi i shëtitorës Bashkia Pukë 2016”, kontrata lidhur datë 7.10.2016 me vlerë 95,997,608 lekë pa tvsh.

-Për kualifikimin dhe shpalljen fituese OE “J...k” shpk në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion qendra Luf 2016”, në kushtet e mosplotësimit të 2 kriterëve, çka ka shkaktuar vlerën 2,944,869 lekë mos efektivitet në përdorimin e fondeve publike, si diferencë midis OE “J...u” dhe OE “E...t”, pasi edhe OE “E...t” shpk nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret por ka pasur ofertën më të ulët.

-Për kualifikimin dhe shpalljen fitues në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemim, asfaltim i lagjes pas pallatit Kulturës 2016” të OE “A...x” shpk me ofertën me vlerën më të lartë, duke mos i dhënë prioritet faktorit ekonomik dhe në kushte e mos plotësimit të kriterëve të kualifikimit të DST, me pasojë vlerën 2,006,960 lekë mos efektivitet në përdorimin e fondeve publike, si diferencë midis OE fitues “A...x” dhe OE “J...k”, pasi edhe operatori “Junik” është në kushtet e mos plotësimit të kriterëve.

-Për kualifikimin dhe shpalljen fituese të OE “A...p” shpk, në procedurën e prokurimit “Blerje Automjete për menaxhimin e mbetjeve urbane, fadromë dhe makinë teknologjike 2016”, pasi nuk plotëson kriteret e kualifikimit, konkretisht kriterin e shlyerjes së detyrimeve të taksave vendore për vitin 2016, në kundërshtim me kërkesat e DST pika 1.2/c, pasi për të

njëjtën shkelje KVO ka s,kualifikuar BOE “A...l” & “A...x” në procedurën e prokurimit “Shërbime, lyerje, riparime në objektet në vartësi të Bashkisë Pukë 2015”.

-Për mos kualifikimin dhe shpalljen fituese të ofertës me vlerë më lartë të OE “D...x” shpk, në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbime, lyerje, riparime në objektet në vartësi të Bashkisë Pukë 2015”, në kushtet e mos plotësimit të kriterëve, ku tenderi duhej anuluar. Në këto kusht KVO mund të kualifikonte ofertën më të ulët të BOE “A...l” shpk & “A...x” i vetmi në garë, çka ka shkaktuar vlerën 215,889 lekë dëm ekonomik (2,846,000 - 2,630,111).

-Për mos s,kualifikimin e OE fitues “A...l” shpk të paktën në 1 nga procedurat të zhvilluara më datë 24.6.2016, në objektet “Ndërtim mulliri me ujë Rrype 2016” dhe “Ndërtim mulliri me ujë Lumzi Rrape 2016, “Ndërtime ure pasarel Kabash ”, pasi nuk plotëson kriteret.

Veprime në kundërshtim me nenet 20, 23, 46, 53/4, 54 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu VII neni 14/5 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

II. Ish Komuna Qerret për 4 persona,si më poshtë:

10.1. Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj **Titullarit të Autoritetit Kontraktor të ish-Komunës Qerret, z. R. D.**, për arsyet e mëposhtme:

-Për mos anulimin e procedurës së prokurimit publik me objekt: “Magazinë frigoriferike frutash 2015” për vlerën totale 9,875,616 lekë në 2 fazat, sipas kontratave nr.1, datë 24.4.2014 dhe nr.1, datë 28.01.2015, pasi procedura e prokurimit publik paraqet shkelje ligjore, konkretisht OE fitues “A...n” shpk nuk plotëson kriteret e kualifikimit të DST dhe paraqet vlerën më të lartë madje baras me fondin limit, për rrjedhojë nuk i është dhënë prioritet faktorit ekonomik.

-Për shkaktimin e vlerës 10 milion lekë mos efektivitet të fondeve publike, pasi magazina frigoriferike nuk është në funksion të qëllimit të ndërtimit saj, duke mos u zbatuar përgjegjshmëria e drejtuesve dhe menaxherëve të tjerë kryesorë që janë pjesë e vendim marrjes në përdorimin e fondeve publike si dhe mos ushtrimin e transparencës në administrimin e këtij fondi.

Veprime në kundërshtim me nenin 1, 12, 24 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, me nenin 1, 73 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” etj.

Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj anëtarëve të **Komisionit të Vlerësimit të Ofertave** të ish-Komunës Qerret, konkretisht:

11.2. L. V., me detyrë ish-specialist dhe në cilësinë e kryetarit të KVO,

12.3. R. H., me detyrë ish-specialiste dhe në cilësinë e anëtares të KVO,

13.4. F. H., me detyrë ish-specialist dhe në cilësinë e anëtarit të KVO,

Për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:

-Për kualifikim të padrejtë të OE fitues “A...n” shpk. në procedurën e prokurimit publik me objekt “Magazinë frigoriferike frutash 2015”, kontrata nr. 1, datë 28.01.2015, pasi nuk plotëson kriteret e kualifikimit të DST, paraqet vlerën më të lartë madje baras me fondin limit, pra KVO nuk i ka dhënë prioritet faktorit ekonomik, për rrjedhojë tenderi duhej të anulohet. Veprime në kundërshtim me nenin 1, 45, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, me nenin 1, 15, 31/1, 58, 66, 67 dhe 73 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

III. Ish Komuna Gjegjan, për 7 persona,si më poshtë:

14.1. Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj **Titullarit të Autoritetit Kontraktor të ish-Komunës Gjegjan Pukë z. N. C.**, për arsyet e mëposhtme:

-Për mos anulimin e procedurës të prokurimit publik me objekt "Ndërtim i 2 urave auto tip bailey në përroin e Xhepes dhe të Mesuli, 2014", kontrata datë 26.6.2014 me vlerë 3,072,000 lekë me tvsh, pasi rezulton me shkelje ligjore, në zgjedhjen e procedurës, në hartimin e kushteve dhe kriterëve të kualifikimit, mos plotësim të kriterëve të kualifikimit nga OE fitues "A...I" shpk. Veprime në kundërshtim me nenin 12, 24 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar.

-Për miratimin e dosjes të procedurës të prokurimit publik me objekt "Ndërtime dhe rikonstruksione në 3 ura tip bailey Kushnen, Kalivare dhe rrugë Gojan 2015", me mangësi dokumentare dhe anomali në hartimin e tyre, konkretisht:

*Procesverbali datë 10.3.2015 i NJP nuk pasqyron asnjë kriter kualifikimi, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 61/2 etj.

*Nuk është mbajtur procesverbali dhe raporti përmbledhës i KVO, pra nuk bëhet fjalë për përshkrimin me hollësi të gjitha etapave të zhvillimit të procedurës, në kundërshtim me kërkesat e nenit 12 të Ligjit 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", pika 2,

Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj anëtarëve të **Njësisë të Prokurimit të ish-Komunës Gjegjan Pukë**, konkretisht:

15.2. T. P., me detyrë ish-specialist dhe në cilësinë e kryetarit të Njësisë të Prokurimit,

16.3. A. Z., me detyrë ish-specialist dhe në cilësinë e anëtarit të Njësisë të Prokurimit,

17.4. N. N., me detyrë ish-specialist dhe në cilësinë e anëtarit të Njësisë të Prokurimit,

Për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:

a. Për shkelje në zgjedhjen e procedurës me objekt "Ndërtim i 2 urave auto tip bailey në përroin e Xhepes dhe të Mesuli, 2014", datë 26.6.2014 me vlerë 3,072,000 lekë me tvsh.

pasi është aplikuar "Procedura me negocim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës" në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 33, pika 1, 6 dhe pika 2 germa "c". Në këtë rast nuk ka patur nevoja ekstreme. NJP nuk ka dokumentuar dhe argumentuar shkaqet e përdorimit të kësaj procedure, sipas kërkesës së VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, kreu IV "Llojet dhe përzgjedhja e procedurës", pika 5, germa "a", duke shmangur procedurat e hapura në rrugë elektronike ka shmangur konkurrencën dhe pjesëmarrjen e kandidatëve të tjerë.

-Për mangësi dokumentacioni në dosjen e tenderit, në kundërshtim me nenin 41, të LPP, kreu V, pika 2, pikat a, b dhe c, e RRPP, përkatësisht:

-procesverbali nr. 01, datë 19.6.2014 i NJP paraqet mangësi, disa kriterë kualifikuese nuk janë vendosur, mungon përcaktimi i numrit të fuqisë punëtore, stafit teknik si dhe periudha për paraqitjen e listë pagesave të sigurimeve shoqërore, mungon përcaktimi i vitit për shlyerjen e detyrimeve vendore, mungon kriteri për kategoritë e licencës së shoqërisë, mungon kriteri për numrin dhe llojin e mjeteve në dispozicion etj.

-procesverbali nr. 02, datë 19.6.2014 dhe raporti përmbledhës i KVO paraqet mangësi dhe nuk përshkruan me hollësi gjitha etapat e zhvillimit të procedurës, në kundërshtim me kërkesat e nenit 12 të Ligjit 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar pika 2.

-Nuk janë formuluar deklaratat për konfliktin e interesit nga NJP dhe KVO, sipas VKM nr 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu V, pika 1 germa "a".

b. Për mangësi dhe anomali në hartimin e dokumenteve të dosjes të procedurës të prokurimit publik me objekt "Ndërtime dhe rikonstruksione në 3 ura tip bailey Kushnen, Kalivare dhe rrugë Gojan 2015", konkretisht: procesverbali datë 10.3.2015 i NJP nuk pasqyron asnjë kriter kualifikimi, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar, me nenin 61/2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”. Dosja e tenderit ka mangësi në dokumentacion, konkretisht nuk administrohen në dosjen e procedurave të prokurimit DST të tenderit, në kundërshtim me nenin 41, të LPP, kreu V, pika 2, pikat a, b dhe c, e RRPP. Procesverbal datë 10.3.2015 i NJP nuk paraqet asgjë, pasi nuk pasqyrojnë asnjë kriter kualifikimi. Nuk bëhet fjalë për argumentimin e vendosjes së kriterëve për kualifikim, pasi nuk janë hartuar ato, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61/2 etj.

Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj anëtarëve të **Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të ish-Komunës Gjegjan**, konkretisht:

18.5. M. G., me detyrë ish-specialist dhe në cilësinë e kryetarit të KVO,

19.6. M. F., me detyrë ish-specialist dhe në cilësinë e anëtares të KVO,

20.7. I. S., me detyrë ish-specialist dhe në cilësinë e anëtarit të KVO,

Për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:

a. Për shkelje në procedurën e prokurimit publik *me objekt "Ndërtim i 2 urave auto tip bailey në përroin e Xhepes dhe të Mesuli, Komuna Gjegjan Pukë 2014"*, pasi OE fitues "A...I" shpk nuk plotëson kriteret e kualifikimit, përkatësisht:

- kriterin e shlyerjes së detyrimeve të taksave vendore për vitin 2014, pasi është debitor për vlerën 548,821 lekë, sipas vërtetimit nga drejtoria e tatimeve Shkodër nr. 3053, datë 22.5.2014, në kundërshtim me kërkesat e DST pika 3/a sipas procesverbalit nr. 1, datë 19.6.2014 të NJP.

- kriterin "për punë të ngjashme", pasi nuk plotësohet vlera 50 % e 1 kontrate të vetme brenda 3 viteve të fundit dhe as 2-fishi i vlerës së kontratës së prokuruar, në kundërshtim me Kreun III "pika 3 "dokumentet e tenderit" pika 2/c të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.

b. Për parregullsi në procedurën e prokurimit publik me objekt "Ndërtime dhe rikonstruksione në 3 ura tip bailey Kushnen, Kalivare dhe rrugë Gojan 2015", pasi nuk kuptohet si ka gjykuar KVO për kualifikimin ose s,kualifikimin e operatorëve ekonomik, nën mungesën e kriterëve të kualifikimit, çka e bën të qartë favorizimin e OE "A...I" shpk edhe në objektin "Ndërtim i 2 urave auto tip bailey në përroin e Xhepes dhe Mesuli, Komuna Gjegjan 2014", në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Shënim: Nuk propozohet masa për ish-komunat Rrapë dhe Qelëz, pasi konstatohen shkelje ligjore pa efekte financiare, secila me nga 1 tender të audituar, me fond limit në nivelin e procedurave të drejtpërdrejta.

E. PËR INSPEKTIM FINANCIAR (Ministria e Financave)

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15 shkronjat "i" dhe "f", si dhe në ligjin nr. 112/2015 datë 15.10.2015 "Për inspektimin financiar publik" neni 8, i rekomandojmë Inspektimit Financiar, të kryejë inspektime dhe auditime lidhur me konstatimet si më poshtë:

1.R. D. me detyrë me detyrë ish Kryetar i Komunës Qerret

2. P. F. me detyrë ish P/Financës ish Komuna Qerret.

a- Në ish Komunën Qerret, aktualisht Njësi administrative në përbërje të Bashkisë Pukë, nga auditimi është konstatuar se pa u mbështetur në dispozita ligjore nga fondet e ish-Komunës

Qerret, kanë kryer shpenzime për sponsorizimin e shoqatës “**T...a**” në 3 raste për **vlerën 500,000 lekë**, nga të cilat në vitin 2013 për 200.000 lekë, në vitin 2014 për 150.000 lekë dhe viti 2015 për 150.000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik i ndryshuar”, ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet” i ndryshuar nenet 3, 4 dhe ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, neni 18. Konkretisht, pagesat janë bërë me urdhër shpenzimet nr. 76, datë 06.05.2013, fatura e thjeshtë tatimore nr. 6, datë 11.04.2013 për Aktivitet “Lojra Popullore 2013” në shumën 200.000 lekë, me urdhër shpenzimi nr. 79, datë 12.05.2014, fatura e thjeshtë tatimore nr. 10, datë 14.04.2014 për shumën 150,000 lekë dhe me urdhër shpenzimi nr. 79, datë 19.05.2015, për vlerën 150.000 lekë, fatura e thjeshtë tatimore nr. 16, datë 27.4.2015 për aktivitet lojra popullore në shumën 150.000 lekë.

b-Në vitin 2014, nga ish Komuna Qerret, janë kryer në 2 raste shpenzime për pritje dhe përcjellje në **shumën 80,000 lekë**. Këto shpenzime janë kryer pa pasur program të miratuar, nuk ka listë emërore të përfituesve, nuk ka procesverbal të komisionit të blerjeve dhe shërbimeve me vlera të vogla për kryerjen e këtij shpenzimi, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” i ndryshuar pikat 7, 8, 12 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-40. Konkretisht, pagesat janë bërë me urdhër shpenzimi nr. 73, datë 24.04.2014, fatura e thjeshtë tatimore nr. 4, datë 23.04.2014 dhe me urdhër shpenzimi nr. 179, datë 23.09.2014, fatura e thjeshtë tatimore nr. ska, datë 15.04.2014.

c-Ish Komuna Qerret ka pasur në administrim, automjetin e dhuruar nga shoqata “**T...a**”, Tip Sreyr-Punch me targa PU 1518 A, i pa vlerësuar në vlerë lekë dhe i pa dokumentuar me akt dhurimit. Nga Bashkia Pukë, nuk është regjistruar në kontabilitete dhe nuk është inventarizuar ky automjet.

Në këtë rast, mungesa e automjetit, **përbën dëm ekonomik** për Bashkinë Pukë, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. III pikat 26, 35/b, 35/c, Kap IV, pika 73 si dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

d-Nga ish Komuna Gjegjan, është paguar subjekti “E...i” shpk në **shumën 358,800 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, për ndërtim linje TM për furnizim me energji elektrike fshati Kalivarë.

Për këtë shpenzim, është urdhër prokurimi nr. 16, datë 22.04.2015, por mungon dokumentacioni i nevojshëm ligjor; nuk ka preventiv për punimet që do të kryhen, nuk ka situacion të punimeve dhe as akt marrje në dorëzim të punimeve. Fatura nuk është firmosur nga komisioni ose person tjetër përfaqësues të ish Komunës Gjegjan, shkelje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-40.

Shënim:

I- Për 4 ish-punonjësit e larguar nga puna për arsye të reformës territoriale, të Bashkisë dhe ish-Komunave sot Njësi Administrative, nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e

natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë këto masa nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara do të ishte kërkuar masë disiplinore, përkatësisht:

- 1-z. F. B. me detyrë ish Kryetar i Komunës Qelëz,
- 2-z. N. G. me detyrë ish Kryetar i Komunës Rrapë,
- 3-z. T. P. me detyrë ish P/Urbanistikës në ish Komunën Gjegjan,
- 4-z. E. S. me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës së Financës ish Komuna Qelëz.

II- Për 3 punonjësit si më poshtë, nuk propozojmë masa disiplinore, pasi shkeljet e konstatuara megjithëse ekzistojnë, ato mund të ezaurohen si të tilla në të ardhmen duke zbatuar rekomandimet nga ky auditim:

- 1-z. B. A. me detyrë P/Zyrës së Shërbimeve,
- 2-z. H. D. me detyrë P/Zyrës së Tatim Taksave Bashkia Pukë, periudha 10.10.2012 e ne vazhdim,
- 3-zj. E. Ç. me detyrë Specialisti në Zyrën e Tatim Taksave Bashkia Pukë për periudhën 20.12.2015 e ne vazhdim.

F. TË TJERA:

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit këtë auditim e vlerëson dobët, pasi puna e bërë nga grupi i auditimit konsiderohet e paplotë në drejtim të auditimit të procedurave të prokurimit publik, për këtë arsye, procedurat e prokurimit do të riauditohen në një periudhë të mëvonshme.

Për të përcaktuar saktë mangësitë në këtë auditim, Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, ta analizojnë Raportin Përfundimtar të Auditimit me të gjithë audituesit e Departamentit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R